

PHILIPS

Air Performer

2-in-1 Air Purifier and Fan

7000i Series



AMF765



Manuali i përdorimit

Përmbajtja

1	E rëndësishme	1
	Siguria	1
	Fushat elektromagnetike (EMF)	3
	Riciklimi	3
2	Air Performer juaj	4
	Përmbledhje e produktit	4
	Përmbledhje e ekranit	5
	Përmbledhje e telekomandës	6
3	Hapat e parë në fillim	7
	Instalimi i filtrit	7
	Përdorimi i telekomandës për herë të parë	7
	Funksionimi i treguesit të Wi-Fi	7
	Lidhja me Wi-Fi	8
4	Përdorimi i Air Performer	9
	Kuptimi i nivelit të cilësisë së ajrit	9
	Ndezja dhe fikja	10
	Rrotullimi	10
	Çelësi i funksionit	10
	Caktimi i shpejtësisë së ventilatorit	11
	Modaliteti "Turbo"	11
	Çelësi i modalitetit	12
	Vendosja e bllokimit për fëmijët	12
	Vendosja e kohëmatësit	13
	Sensori i dritës	13
5	Pastrimi dhe mirëmbajtja	13
	Grafiku i pastrimit	13
	Pastrimi i trupit të Air Performer	14
	Pastrimi i sensorit të grimcave	14
	Pastrimi i sipërfaqes së filtrit	14
	Ndërrimi i filtrit	15
	Resetimi i kohës së filtrit	16
	Ndërrimi i baterive	17
6	Ruajtja	18
7	Zgjidhja e problemeve	18
8	Garancia dhe mbështetja	20
	Porositja e pjesëve ose aksesorëve	20

1 E rëndësishme

Siguria

Lexoni me kujdes këtë manual përdorimi përpara se ta vini në punë pajisjen dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Për të siguruar performancë optimale, sigurohuni që Air Performer të përditësohet në versionin e fundit. Këtë përditësim mund ta bëni përmes aplikacionit Air+.

Rrezik

- Mos lejoni futjen brenda pajisjes të ndonjë lëngu apo detergjenti që merr flakë, në mënyrë që të shmangni rrezikun e goditjes elektrike dhe/ose rrezikun për zjarr.

Paralajmërim

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart dhe nga persona me aftësi të kufizuara fizike, shqisore ose mendore apo që kanë mungesë përvoje dhe njohurish, vetëm nëse ata mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe nëse kuptojnë rreziqet e përfshira.
- Mbani larg fëmijët nën 3 vjeç, përveçse kur mbikëqyren në vazhdimësi.
- Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja nuk duhen kryer nga fëmijët pa qenë të mbikëqyruar.
- Mos bllokoni vrimat e hyrjes dhe të daljes së ajrit, p.sh. duke vendosur objekte mbi vrimën e daljes së ajrit ose përballë vrimës së daljes së ajrit.
- Mos futni gishtat, shkopinj ose objekte të tjera brenda në pajisje, në mënyrë që të shmangni goditjet elektrike, lëndimin fizik ose zjarrin.
- Mos e përdorni pajisjen pranë pajisjeve me gaz ose oxhakëve të zjarrit.
- Mos spërkatni përreth pajisjes materiale që marrin flakë, të tilla si insekticidet apo parfumet.
- Mos e përdorni nëse ka shenja të dukshme dëmtimi në pajisje, në spinën elektrike ose në kordonin elektrik.
- Mos e përdorni pajisjen nëse ajo është rrëzuar nga lart.
- Nëse kordoni elektrik është i dëmtuar, ai duhet ndërruar nga "Philips", nga një pikë shërbimi e autorizuar nga "Philips" ose nga persona me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangni rreziqet.

Kujdes

- Përdorni vetëm filtër origjinal "Philips", sepse përndryshe rendimenti i filtrimit nuk është i garantuar.
- Pajisja nuk duhet vendosur direkt poshtë një prize elektrike.
- Gjithmonë vendoseni dhe përdoreni pajisjen mbi një sipërfaqe të thatë, të qëndrueshme dhe horizontale.

- Mos e përdorni pajisjen në ambiente me lagështi të lartë, si për shembull në banjë, tualet, kuzhinë, pishinë apo në ambient jashtë.
- Mos u ulni ose mos u mbështetni mbi pajisje. Mos e goditni pajisjen. Mos vendosni asgjë mbi pajisje.
- Hiqni gjithmonë spinën e pajisjes kur dëshironi që ta lëvizni, të pastroni pajisjen, të ndërroni filtrin apo kur doni të kryeni ndonjë mirëmbajtje tjetër.
- Kur ndizni pajisjen, filtri duhet të jetë gjithmonë i vendosur.
- Kjo pajisje është parashikuar vetëm për përdorim familjar në kushte pune normale.
- Sugjerohet të mos e përdorni këtë pajisje kur pini duhan apo kur përdorni largues insektesh të llojit me tym ose djegie me tym, etj., sepse kjo do të ndikonte në rezultatin e pastrimit dhe në jetëgjatësinë e filtrit.
- Pajisja nuk largon monoksidin e karbonit (CO) ose radonin (Rn). Nuk mund të përdoret si pajisje sigurie në rastin e aksidenteve me proceset e djegies dhe me kimikatet e rrezikshme.



VINI RE

KY PRODUKT PËRMBAN NJË BATERI PETË

Nëse gëlltitet, bateria petë e litiumit mund të shkaktojë lëndime të rënda ose vdekjeprurëse brenda 2 orëve.

Mbajini bateritë larg fëmijëve.

Nëse mendoni se bateritë mund të jenë gëlltitur ose futur në brendësi të ndonjë pjese të trupit, kërkoni menjëherë kujdesin mjekësor.

- Nëse telekomanda nuk do të përdoret për një kohë të gjatë, hiqni baterinë nga telekomanda për të shmangur rrjedhjen e baterisë.
- Nëse lëngu që rrjedh nga bateria hyn aksidentalisht në sy, shpëlani sytë me ujë të pastër të rrjedhshëm dhe më pas kërkoni vëmendje mjekësore.
- Nëse lëngu që rrjedh nga bateria bie në kontakt me lëkurën ose rrobat, shpëlajini menjëherë me ujë të pastër të rrjedhshëm.
- Ky është një produkt laser i kategorisë 3R, shmangni ekspozimin direkt në sy. Komponenti laser është pjesë e sensorit të grimcave dhe nuk mund të preket ose të shihet gjatë përdorimit normal.
- Fuqia maks. 5.0mW, gjatësia e valës 650nm, valë e vazhduar, rreze e drejtuar.



Nëpërmjet këtij dokumenti, DAP B.V. deklaron se radiopajisja e llojit AMF765 është në përputhje me direktivën 2014/53/BE. Teksti i plotë i deklaratës së konformitetit të BE-së gjendet në adresën e mëposhtme të internetit: www.philips.com.

Ndërfaqja standarde WiFi e bazuar në 802.11b/g/n/ax në 2,4 GHz me kapacitet maksimal prej 64 mW EIRP.

Bluetooth versioni 5.2 (LE) në frekuencë 2,4 GHz me kapacitet RF nën 10 mW EIRP.

Fushat elektromagnetike (EMF)

Kjo pajisje është në përputhje me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Riciklimi

Ky simbol do të thotë që produkti nuk duhet të hidhet me mbeturinat normale të shtëpisë (2012/19/BE).



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri të njëpërdorimëshe që nuk duhen hedhur me mbeturinat normale shtëpiake (2006/66/KE).



Ndiqni rregullat shtetërore për hedhjen e veçuar të produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Hedhja e duhur ndihmon në parandalimin e pasojave negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.



Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Vetëm telekomanda përmban bateri njëpërdorimëshe.

Për të hequr bateritë njëpërdorimëshe shihni udhëzimet për vendosjen dhe/ose heqjen e baterive në manualin e përdorimit.


Hiqini gjithnjë nga produkti bateritë e shkarkuara njëpërdorimëshe. Merrni masat e nevojshme paraprake kur hidhni bateritë.

2 Air Performer juaj


Urime për blerjen dhe mirë se vini te Philips!

Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron "Philips", regjistroni produktin në faqen www.philips.com/welcome.

Përmbledhje e produktit














Përmbledhje e ekranit




Butoni i kontrollit

	Butoni i ndezjes/fikjes
--	-------------------------

Paneli i ekranit

	Treguesi i Wi-Fi		Sinjali për pastrimin e filtrit
	Sinjali për ndërrimin e filtrit	PM 2.5	Ekrani PM2.5
	Modaliteti "Auto"		Modaliteti "Turbo"
	Modaliteti i kontrolluar nga aplikacioni		Modaliteti "Sleep"
	Treguesi i bllokimit për fëmijët		Funksioni i qarkullimit
	Funksioni i ventilatorit		Niveli i cilësisë së ajrit

Përmbledhje e telekomandës



*Shtyp 3s: Modaliteti turbo (@)


**Shtyp 3s: Siguresa për fëmijët (🔒)

3 Hapat e parë në fillim

Instalimi i filtrit

Hiqni të gjithë paketimin e filtrit përpara përdorimit të parë.

Shënim: Sigurohuni që Air Performer të jetë hequr nga prizja përpara instalimit të filtrit.



- 1 Tërhiqni kapakun e pasmë dhe hiqeni nga pajisja.
- 2 Nxirrni filtrin nga pajisja.
- 3 Hiqni të gjitha materialet e paketimit nga filtri i pastrimit të ajrit.
- 4 Vendoseni sërish filtrin në pajisje.
- 5 Rivendosni kapakun e pasmë.

Përdorimi i telekomandës për herë të parë

Kujdes:

- **Rrezik dëmtimi të produktit! Kur telekomanda nuk përdoret për periudha të gjata, hiqni baterinë.**
- **Bateria përmban substanca kimike, prandaj duhet të hidhen siç duhet.**
- **Futni pajisjen në prizë; mos përdorni zgjatues shumëprizësh.**

- 1 Tërhiqni shiritin plastik në telekomandë për të aktivizuar baterinë.
- 2 Mund ta vendosni telekomandën në pjesën e sipërme të pajisjes, dhe fiksohet automatikisht në vend.





Funksionimi i treguesit të Wi-Fi

Statusi i ikonës së Wi-Fi	Statusi i lidhjes së Wi-Fi
Pulson në portokalli	Duke u lidhur me smartfonin
Ndezur në portokalli	I lidhur me smartfonin
Pulson në bardhë	Duke u lidhur me serverin
Ndezur në të bardhë	I lidhur me serverin
Joaktiv	Funksioni Wi-Fi i çaktivizuar

Lidhja me Wi-Fi

Konfigurimi për herë të parë i lidhjes me Wi-Fi






- 1 Shkarkoni e instaloni programin **Philips Air+** nga **App Store** ose **Google Play**.
- 2 Vendoseni spinën e Air Performer në prizë dhe prekni  për ta ndezur.
↳ Treguesi i Wi-Fi  pulson në portokalli për herë të parë.
- 3 Sigurohuni që smartfoni ose tableta juaj të jetë lidhur me sukses me rrjetin tuaj Wi-Fi.
- 4 Hapni programin **Philips Air+** dhe klikoni mbi **“Connect a New Device”** ose shtypni butonin **“+”** në krye të ekranit. Ndiqni udhëzimet në ekran për të lidhur Air Performer me rrjetin tuaj.

Shënim:

- Ky udhëzim vlen vetëm kur Air Performer konfigurohet për herë të parë. Nëse rrjeti ka ndryshuar ose konfigurimi duhet kryer sërish, shih kapitullin **“Rivendosja e lidhjes me Wi-Fi”** në faqen 8.
- Nëse doni të lidhni më shumë se një Air Performer me smartfonin apo tabletën, duhet t'i bëni një nga një.
- Sigurohuni që distanca mes smartfonit apo tabletës dhe Air Performer të jetë më pak se 10 m pa ndonjë pengesë.

Rivendosja e lidhjes me Wi-Fi

Shënim:


- Rivendosni lidhjen Wi-Fi nëse ndryshoni rrjetin tuaj bazë.
- 1 Vendoseni spinën e Air Performer në prizë dhe shtypni  për ta ndezur.
 - 2 Shtypni gjatë butonin  në pajisje për 7 sekonda derisa të fiket dhe të ndizet përsëri, treguesi i Wi-Fi  pulson në portokalli.
↳ Air Performer kalon në modalitet çiftimi.
 - 3 Ndiqni hapat 3-4 te seksioni **“Konfigurimi i lidhjes Wi-Fi për herë të parë”**.

4 Përdorimi i Air Performer

Kuptimi i nivelit të cilësisë së ajrit

Niveli i cilësisë së ajrit ndizet automatikisht kur ndizet Air Performer dhe ndriçon me të gjitha ngjyrat njëra pas tjetrës. Pas rreth 30 sekondash punë, sensori i grimcave zgjedh ngjyrën që përkon me cilësinë e ajrit përreth grimcave në ajër.

Ngjyra e dritës së cilësisë së ajrit përcaktohet nga PM2.5 (grimca më të vogla se 2.5 mikronë). Niveli i lagështisë relative (RH) ofrohet vetëm përmes programit.



PM2.5

Teknologjia e detektimit **AeraSense** detekton me saktësi dhe reagon shpejt edhe ndaj ndryshimeve më të vogla të grimcave në ajër. Ai ju ofron sigurinë e sinjalizimit PM2.5 në kohë reale.



Shumica e ndotësve të ajrit të brendshëm bie nën PM2.5 – që u referohet grimcave që barten në ajër më të vogla se 2,5 mikrometra. Burimet e zakonshme të ambienteve të mbyllura për grimca të imëta janë tymi i duhanit, gatimi, djegia e qirinjve. Disa baktere që barten nga ajri dhe sporet më të imëta të mykut, alergjenëve të kafshëve shtëpiake dhe grimcave alergjenëve të morrave të përfshihen gjithashtu nën PM2.5.


Niveli i PM2.5	Ngjyra e dritës së cilësisë së ajrit	Niveli i cilësisë së ajrit
≤12	Blu	I mirë
13-35	Blu-e purpurt	I pranueshëm
36-55	E purpurt-e kuqe	I keq
>55	E kuqe	Shumë i keq

Ndezja dhe fikja

Shënim:


- Për një performancë optimale në pastrim, mbyllni dyert dhe dritaret.
- Mbjajni perdet larg hyrjes së ajrit apo daljes së ajrit.
- Futni pajisjen në prizë; mos përdorni zgjatues shumëprizësh.

- 1 Futni Air Performer në prizë.
- 2 Shtypni  për të ndezur Air Performer.
 - ↳ Air Performer tingëllon.
 - ↳ Në ekran shfaqet "---" gjatë nxehtësisë. Në vijim Air Performer tregon nivelin e PM2.5 pas matjes së cilësisë së ajrit.
- 3 Prekni e mbani butonin  për 3 sekonda për ta fikur Air Performer.



Shënim: Nëse Air Performer qëndron i lidhur në prizë pasi FIKET, do të punojë me cilësimet e mëparshme kur të RINDIZET.

Rrotullimi




Shtypni butonin  për të aktivizuar funksionin e rrotullimit të Air Performer, pajisja mund të rrotullohet në këto kënde: 45°, 90°, 180°, 270°, 350° dhe FIKUR.

- ↳ Në ekran shfaqet këndi i rrotullimit.
- ↳ Nëse nuk kryhet asnjë veprim brenda 3 sekondave,

pajisja kthehet në ekranin normal.



Çelësi i funksionit

Mund ta zgjidhni funksionin Circulation () ose Fan () duke shtypur butonin . Mund ta rregulloni manualisht shpejtësinë e ventilatorit; shihni seksionin "**Caktimi i shpejtësisë së ventilatorit.**"



Funksioni Circulation ():



Shpërndan fluksin e ajrit të shpërhapur për qarkullim optimal të ajrit duke hapur daljen e pasme, duke maksimizuar rendimentin e pastrimit dhe duke reduktuar ndjesinë e ftohjes. Në shpejtësi më të larta, një rrymë e butë ajri do të fryjë më fort nëpër daljen e përparme për të rritur fuqinë e pastrimit.




Funksioni Fan ():

Krijon një fluks ajri të fuqishëm dhe të pastër që ndihet i natyrshëm dhe i këndshëm. Falë projektimit pa fletë, nuk fryn shkulma ajri, duke krijuar një rrymë të qëndrueshme ajri nga ventilatori.

Caktimi i shpejtësisë së ventilatorit

Mund ta caktoni manualisht shpejtësinë e ventilatorit duke shtypur butonin e shigjetës ( / ) në telekomandë, që shkon nga 1 në 10.



- ↳ Nëse nuk kryhet asnjë veprim brenda 3 sekondave, pajisja kthehet në ekranin normal.



Modaliteti "Turbo"

Shënim:


- Ky modalitet e kalon pajisjen në modalitetin e qarkullimit për të maksimizuar rendimentin e pastrimit.

Pajisja hap të gjitha vrimat e ajrit dhe e pastron ajrin në shpejtësi maksimale. Shtypni e mbani butonin  për 3 sekonda për të aktivizuar modalitetin Turbo ().

- ↳ Në ekran shfaqet treguesi .
- ↳ Pajisja kalon automatikisht në funksionin Circulation dhe punon me shpejtësinë më të lartë.



Çelësi i modalitetit

Mund të zgjidhni modalitetin Auto ose Sleep duke shtypur butonin .

Shënim:

- **Modaliteti App-operated ofrohet VETËM përmes aplikacionit pas lidhjes së suksesshme me Wi-Fi.**



Auto (A): Pajisja rregullon automatikisht cilësimet për të ofruar rendimentin më të mirë.







Modaliteti Sleep (C): Pajisja funksionon në heshtje me shpejtësi të ulët. Pas 3 sekondave, drita e ekranit fiket.



Modaliteti App-operated (📶): Pajisja është duke përdorur një modalitet që ofrohet vetëm përmes aplikacionit.



Vendosja e bllokimit për fëmijët

- 1 Shtypni butonin  për 3 sekonda për të çaktivizuar siguresën për fëmijët.
↳  shfaqet në ekran.
- 2 Shtypni sërish butonin  për 3 sekonda për të çaktivizuar siguresën për fëmijët.
↳  largohet nga ekrani.



Vendosja e kohëmatësit

Me anë të kohëmatësit mund ta lini pajisjen të funksionojë për një numër të caktuar orësh. Kur të ketë kaluar koha e caktuar, pajisja do të fiket automatikisht.

- 1 Shtypni butonin  disa herë për të zgjedhur numrin e orëve që dëshironi të punojë pajisja .
↳ Ofrohen **0.5h, 1h, 4h** ose **8h** .
- 2 Për të çaktivizuar kohëmatësin, shtypni butonin  në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet OFF në ekran.



Sensori i dritës

Me sensor drite:

- Drita e panelit të kontrollit mund të ndizet, të fiket ose të errësohet automatikisht sipas dritës së ambientit.
- Drita e panelit të kontrollit do të jetë e fikur ose e errësuar nëse drita e ambientit është e errët.


Mund të prekni një buton çfarëdo për të rindezur të gjitha dritat. Nëse nuk kryhet asnjë veprim tjetër, të gjitha dritat do të fiken ose do të errësohen përsëri për t'u përshtatur me dritën e ambientit.

5 Pastrimi dhe mirëmbajtja

Shënim:

- *Hiqeni gjithmonë pajisjen nga priza përpara se ta pastroni.*
- *Mos e zhytni kurrë pajisjen në ujë apo në lëngje të tjera.*
- *Mos përdorni kurrë agjentë pastrues gërryes, agresivë ose që marrin flakë, si për shembull klor apo alkool, për të pastruar pjesët e pajisjes.*
- *Mos përdorni kurrë lëngje (duke përfshirë ujin) për pastrimin e filtrit.*

Grafiku i pastrimit

Shpeshtësia	Mënyra e pastrimit
Kur nevojitet	Fshini sipërfaqen plastike të pajisjes me një leckë të butë e të thatë
	Pastroni kapakun e vrimës së daljes së ajrit
Çdo dy muaj	Pastrojeni sensorin e grimcave me fshesë me korrent ose me tampon pambuku të thatë.
 shfaqet në ekran.	Pastrojeni sipërfaqen e filtrit

Pastrimi i trupit të Air Performer

Pastroni rregullisht pjesën e brendshme dhe të jashtme të Air Performer për të parandaluar grumbullimin e pluhurit.


- Përdorni një leckë të butë e të thatë për pjesën brenda dhe jashtë Air Performer dhe për vrimën e daljes së ajrit.

Pastrimi i sensorit të grimcave

Pastroni sensorin e grimcave çdo 2 muaj për funksionimin optimal të pajisjes.


Shënim:


- Nëse Air Performer përdoret në ambient me pluhur, mund të duhet të pastrohet më shpesh.
- Nëse niveli i lagështisë në ambient është shumë i lartë, mund të zhvillohet kondensim te sensorin e grimcave dhe cilësia e ajrit mund të tregojë një cilësi ajri më të ulët edhe kur cilësia e ajrit është në fakt e mirë. Nëse ndodh diçka e tillë, pastroni sensorin e grimcave.




- 1 Fikeni Air Performer dhe hiqeni nga priza.
- 2 Pastrojeni sensorin e grimcave me fshesë me korrent ose me tampon pambuku të thatë.




Pastrimi i sipërfaqes së filtrit




Statusi i dritës sinjalizuese të filtrit	Veprimi
Sinjalizimi i pastrimit të filtrit  shfaqet në ekran.	Pastroni sipërfaqen e filtrit me një fshesë me korrent.


- 1 Fikeni Air Performer dhe hiqeni nga priza.



- 2 Tërhiqni kapakun e pasmë dhe hiqeni nga pajisja.
- 3 Nxirrni filtrin nga pajisja.
- 4 Pastroni sipërfaqen e filtrit me një fshesë me korrent.
- 5 Vendoseni sërish filtrin në pajisje.
- 6 Rivendosni kapakun e pasmë.
- 7 Futni Air Performer në prizë.
- 8 Prekni butonin  për të ndezur pajisjen.
- 9 Shtypni e mbani butonin  dhe  për 3 sekonda për të resetuar kohën e pastrimit të filtrit.
- 10 Lajini mirë duart pas pastrimit të filtrit.




Ndërrimi i filtrit


Ky Air Performer vjen i pajisur me një tregues ndërrimi filtri për t'u siguruar që filtri i pastrimit të ajrit të jetë në kushte optimale gjatë funksionimit të Air Performer. Kur filtri duhet ndërruar, sinjali për ndërrimin e filtrit  ndizet në të kuqe.

Ndërrimi i filtrit


Shënim:




- Filtri nuk mund të lahet ose të përdoret përsëri.
- Fikeni gjithnjë Air Performer dhe hiqeni nga prizja përpara ndërrimit të filtrave.




Statusi i dritës sinjalizuese të filtrit	Veprimi
Ndizet sinjali i ndërrimit të filtrit 	Ndërrimi i filtrit (FYM860)

- 1 Fikeni Air Performer dhe hiqeni nga prizja.





- 2 Tërhiqni kapakun e pasmë dhe hiqeni nga pajisja.
- 3 Nxirrni filtrin nga pajisja.
- 4 Hiqni të gjitha materialet e paketimit të filtrit të ri.
- 5 Vendosni filtrin e ri në pajisje.
- 6 Rivendosni kapakun e pasmë.
- 7 Futni Air Performer në prizë.
- 8 Prekni butonin  për të ndezur pajisjen.
- 9 Shtypni e mbani butonin  dhe  për 3 sekonda për të resetuar matësin e jetëgjatësisë së filtrit.
- 10 Lani duart mirë pas ndërrimit të filtrit.







Shënim: Mos i merrni erë filtrit, pasi ka mbledhur ndotës nga ajri.

Resetimi i kohës së filtrit

Filtrin mund ta ndërroni më përpara se të shfaqet në ekran sinjali për ndërrimin e filtrit (). Pas ndërrimit të filtrit ju duhet ta resetoni manualisht numëruesin e jetëgjatësisë së filtrit.

- 1 Mbajeni prekur butonin e energjisë  për 3 sekonda, për ta fikur pajisjen dhe hiqeni nga prizja.




- 2 Futeni pajisjen në prizë.
- 3 Brenda 15 sekondave pas ndezjes, shtypni e mbani  dhe butonin  për 3 sekonda për të resetuar matësin e jetëgjatësisë së filtrit.


Ndërrimi i baterive

Paralajmërim:


- Rreziku i gëlltimit të baterive! Telekomanda përmban një bateri me butona, e cila mund të gëlltimit nga fëmijët. Mbajini gjithmonë bateritë larg fëmijëve!
- Nëse gëlltimit, bateria mund të shkaktojë lëndime serioze ose vdekje. Dëgjie të rënda të brendshme mund të ndodhin brenda dy orëve pas gëlltimit.
- Nëse bateria gëlltimit, kërkoni kujdes të menjëhershëm mjekësor.
- Kur ndërroni bateritë, mbajini gjithmonë të gjitha bateritë e reja dhe të përdorura larg vendeve ku mund të arrihen nga fëmijët.
- Sigurohuni që kapaku i folesë së baterisë të jetë plotësisht i siguar pasi të keni ndërruar baterinë.




- 1 Rrotulloni kapakun e folesë së baterisë në drejtim kundërorar për ta hapur.



- 2 Hiqeni baterinë e përdorur nga foleja e baterisë.



- 3 Futni baterinë e re CR2032 me polaritetin e duhur, siç tregohet.



- 4 Mbyllni kapakun e folesë së baterisë dhe rrotullojeni në drejtim orar për ta mbyllur.




6 Ruajtja

- 1 Fikni Air Performer dhe higjeni nga priza.
- 2 Pastroni Air Performer, sensorin e grimcave dhe sipërfaqen e filtrit (shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja").
- 3 Lërimi të gjitha pjesët të thahen plotësisht në ajër përpara se ta vendosni në ruajtje.
- 4 Mbështillni filtrin me qese plastike hermetike ndaj ajrit.
- 5 Vendoseni Air Performer dhe filtrin në ruajtje në një vend të freskët dhe të thatë.
- 6 Lajini gjithmonë mirë duart pas veprimeve me filtrin.

7 Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përmbledh problemet më të shpeshta që mund të hasni me pajisjen. Nëse nuk keni mundësi ta zgjidhni problemin me informacionin e mëposhtëm, kontaktoni me qendrën e kujdesit për klientin në vendin tuaj.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Rryma e ajrit që del nga vrima e daljes së ajrit është dukshëm më e dobët sesa më parë.	<ul style="list-style-type: none">• Sipërfaqja e filtrit është ndotur. Pastroni sipërfaqen e filtrit (shihni kapitullin "Pastrimi dhe mirëmbajtja").
Cilësia e ajrit nuk përmirësohet, edhe pse pajisja ka qenë në punë për një kohë të gjatë.	<ul style="list-style-type: none">• Kontrolloni nëse keni hequr nga filtri materialin e paketimit.• Kontrolloni nëse filtri është instaluar në pajisje.• Pastrojeni sensorin e grimcave me fshesë me korrent ose me tampon pambuku të thatë.• Dhoma është shumë e madhe ose cilësia e ajrit jashtë është e keqe. Për rendiment optimal në pastrim, mbyllni dyert dhe dritaret gjatë kohës që përdorni pajisjen.• Ka burime ndotëse në ambientin e brendshëm. Shembujt përfshijnë tymin e cigares, tymrat e gatimit, temjanin, parfumin dhe alkoolin.• Filtri ka arritur në fund të jetës së tij. Ndërroni filtrin me një filtër të ri.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Pajisja lëshon një aromë të çuditshme.	<ul style="list-style-type: none"> • HHerët e para që përdorni pajisjen, ajo mund të lëshojë një aromë plastike. Kjo është normale. • Nëse pajisja lëshon një erë djegieje, hiqeni menjëherë nga priza. Kontaktoni me shitësin e "Philips" ose me një qendër servisi të autorizuar nga "Philips". • Filtri mund të lëshojë erë pasi është përdorur për një farë kohe, për shkak të thithjes së gazeve të ambientit të brendshëm. Rekomandohet që ta riaktivizoni filtrin duke e vendosur atë në dritën direkte të diellit për të vazhduar përdorimin e tij. Nëse era mbetet, ndërroni filtrin.
Pajisja bën shumë zhurmë.	<ul style="list-style-type: none"> • Niveli i zhurmës do të jetë më i lartë nëse zgjidhni shpejtësi të lartë. Kaloni në një modalitet me shpejtësi më të ulët. • Nëse ka zhurmë jonormale, kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit për vendin tuaj.
Pajisja tregon ende se duhet të ndërrojë filtrin, ndërkohë që e kam ndërruar atë.	<ul style="list-style-type: none"> • Ndoshta nuk keni resetuar matësin e jetëgjatësisë së filtrit. Ndizni pajisjen. Në vijim shtypni e mbani  dhe  për 3 sekonda.
A mund ta çaktivizoj funksionin Wi-Fi në pajisjen time?	<ul style="list-style-type: none"> • Wi-Fi është një funksion bazë i pajisjes suaj. Për këtë arsye, nuk mund të fiket manualisht. Vini re se funksioni Wi-Fi do të fiket automatikisht nëse pajisja nuk lidhet brenda 15 minutave nga ndezja, pasi të keni lidhur kabllon për herë të parë. Shtypni gjatë butonin  në pajisje për 7 sekonda, për ta riaktivizuar modalitetin e çiftimit.
Çfarë kuptimi kanë kodet në pajisjen time?	<ul style="list-style-type: none"> • Në ekran shfaqet kod i gabimit "E1". Motori ka probleme funksionimi. Kontaktoni me qendrën e kujdesit për klientin në vendin tuaj.
Nuk ka rrymë ajri ose rryma është shumë e dobët nga dalja e ajrit të qarkullimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrolloni nëse pajisja është në funksionin e ventilatorit. • Kontrolloni nëse ka ndonjë objekt të ngecur rreth daljes së ajrit të qarkullimit.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Konfigurimi i Wi-Fi nuk përfundoi me sukses.	<ul style="list-style-type: none"> • Nëse rrugëzuesi në të cilin është lidhur pajisja është me dy banda dhe aktualisht nuk është i lidhur në një rrjet 2.4GHz, kaloni në një bandë tjetër të të njëjtit rrugëzues (2.4GHz) dhe riprovoni ta lidhni Air Performer. Rrjetet 5GHz nuk mbështeten. • Nuk mbështeten rrjetet e autentikimit nga interneti. • Kontrolloni nëse pajisja ndodhet brenda rrezes së rrugëzuesit Wi-Fi. Mund të provoni ta vendosni Air Performer më pranë rrugëzuesit Wi-Fi. • Kontrolloni nëse është saktë emri i rrjetit. Emri i rrjetit bën dallim mes germave të mëdha e të vogla. • Kontrolloni nëse fjalëkalimi i Wi-Fi është i saktë. Fjalëkalimi bën dallim mes germave të mëdha e të vogla. • Provoni përsëri me konfigurimin duke ndjekur udhëzimet në seksionin "Lidhja me Wi-Fi". • Lidhja me Wi-Fi mund të ndërpritet nga interferenca elektromagnetike apo natyre tjetër. Mbajeni pajisjen larg nga pajisjet e tjera elektrike që mund të shkaktojnë interferenca. • Kontrolloni nëse pajisja celulare është në modalitetin e avionit. Sigurohuni që të çaktivizoni modalitetin e avionit kur kryeni lidhje në një rrjet Wi-Fi. • Shihni seksionin e ndihmës në aplikacion për këshilla më të plota dhe më të reja për zgjidhjen e problemeve.

8 Garancia dhe mbështetja

Versuni ofron një garanci dyvjeçare pas blerjes për këtë produkt. Kjo garanci nuk vlen nëse defekti ndodh për shkak përdorimi të gabuar apo mosmirëmbajtjeje. Garancia jonë nuk prek të drejtat tuaja sipas ligjit si konsumator. Për më shumë informacion ose për të përdorur garancinë, ju lutemi të vizitoni faqen tonë të internetit www.philips.com/support.

Porositja e pjesëve ose aksesorëve

Nëse ju duhet të ndërroni një pjesë ose nëse dëshironi të blini një pjesë shtesë, shkoni te shitësi i "Philips" ose vizitoni faqen e internetit www.philips.com/support.

Nëse keni probleme me blerjen e pjesëve kontaktoni me Qendrën e Kujdesit për Klientin të "Philips" në vendin tuaj.



Philips dhe emblema në formë mburoje e Philips janë marka të regjistruara tregtare të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren nën licencë.

Ky produkt është prodhuar dhe shitet me përgjegjësinë e Versuni Holding B.V., dhe Versuni Holding B.V. është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

2023 © Versuni Holding B.V.

AMF765_user manual_v1.0 (22/11/2023)

